

PROGRAMI I STUDIMEVE NË MJEKËSI VETERINARE

Programi i Studimeve në Mjekësi Veterinare synon të formojë profesionistë të kualifikuar dhe të përkushtuar, të gatshëm të kontribuojnë në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të kafshëve, njerëzve dhe mjedisit.

Ky program ofron një formim të plotë teorik dhe praktik, duke i përgatitur studentët për sfidat aktuale dhe të ardhshme në fushën e veterinarisë, shëndetit publik dhe kërkimit shkencor.

Misioni i Programit

Misioni i përgjithshëm i Programit të Studimit në “Mjekësi Veterinare” është të edukojë mjekë veterinarë të nivelit të lartë, të cilët do t’i shërbejnë shoqërisë nëpërmjet përpjekjeve të tyre të vazhdueshme për:

- ✓ Përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve;
- ✓ Garantimin e sigurisë ushqimore;
- ✓ Mbrojtjen e shëndetit publik;
- ✓ Promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor dhe ekonomik.

Formimi Akademik dhe Profesional

Programi ndërthur në mënyrë të balancuar njohuritë bazë biologjike dhe mjekësore me aftësi klinike dhe praktike. Studentët pajisen me përvojë në:

- ✓ Mjekësinë e kafshëve të vogla dhe të mëdha;
- ✓ Diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve infektive dhe jo-infektive;
- ✓ Menaxhimin e shëndetit në fermë;
- ✓ Bio-sigurinë dhe kontrollin e zoonozave;
- ✓ Asistencën në lindje dhe kirurgjinë veterinarë;
- ✓ Përdorimin e teknologjive moderne dhe pajisjeve diagnostikuese.

Qasja “Një Shëndet” (One Health)

Duke u bazuar në konceptin bashkëkohor “Një Shëndet”, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare në Tiranë promovon një qasje ndërdisiplinore ku mjekët veterinarë janë pjesë kyçe në garantimin e shëndetit të kafshëve, mbrojtjen e shëndetit publik dhe ruajtjen e ekosistemeve. Kjo filozofi i përgatit studentët për të punuar në bashkëpunim me mjekë human, biologë, epidemiologë dhe ekspertë të mjedisit.

Kontributi në Zhvillimin Kombëtar

Programi synon të nxisë mbarështimin, mirëqenien dhe prodhimtarinë e kafshëve, duke ndikuar drejtpërdrejt në:

- Rritjen e sigurisë ushqimore;
- Rritjen e cilësisë së produkteve shtazore;
- Mbrojtjen e biodiversitetit dhe shëndetit të mjedisit;
- Rritjen e punësimit dhe zhvillimin e zonave rurale.

QËLLIMET E PROGRAMIT

Ky program studimi synon të zhvillojë aftësitë dhe njohuritë e studentëve për t'u bërë profesionistë të kualifikuar në fushën e Mjekësisë Veterinare, me fokus në praktikat bashkëkohore dhe kërkimet shkencore. Në këtë kuadër, programi ka për qëllim:

- Edukimin e studentëve në njohjen dhe kuptimin e patologjive kryesore që prekin kafshët, duke përfshirë sëmundjet zoonotike me impakt të drejtpërdrejtë në shëndetin publik dhe mjedisin.
- Zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në përdorimin e teknikave diagnostikuese të avancuara dhe inovative, që ofrojnë precizion në identifikimin dhe trajtimin e sëmundjeve të kafshëve.
- Përgatitjen e profesionistëve të aftë në kryerjen e ekzaminimeve klinike të detajuara dhe interpretimeve të anamnezës dhe shenjave klinike, duke integruar njohuritë teorike me praktikat më të mira në fushë.
- Thellimin e njohurive mbi metodologjitë e mbarështimit, përmirësimit gjenetik dhe ushqyerjes së kafshëve, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit dhe mirëqenien e kafshëve.
- Zhvillimin e kompetencave në vlerësimin e masave të profilaksisë, higjienës dhe cilësisë së produkteve me origjinë shtazore, në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë ushqimore.
- Përgatitjen e specialistëve të aftë për të garantuar dhe monitoruar sigurinë ushqimore përgjatë zinxhirit ushqimor, duke përqafuar konceptin modern të “Një Shëndet” (One Health) dhe rolit të veterinarisë në shëndetin publik dhe mjedisor.

KOMPETENCAT E PROGRAMIT

Kompetenca të përgjithshme akademike dhe analitike

Studenti i diplomuar në këtë program do të jetë në gjendje të:

- Interpretojë saktë të dhënat klinike, imazhet diagnostikuese dhe rezultatet e analizave laboratorike.
- Zgjidhë situata komplekse duke u bazuar në aftësinë për të vlerësuar situatat klinike në mënyrë logjike dhe sistematike.
- Ofron ndihmë të shpejtë dhe adekuate bazuar në vlerësimin klinik të kafshëve.
- Realizojë skemat e ndryshme të vaksinimit sipas specieve.
- Interpretojë të dhënat statistikore bazë në studime klinike për epidemiologjinë.

Kompetenca profesionale dhe të specializuara

Studentët do të jenë të aftë të:

- Zbatojnë parimet etike në mjekësinë veterinarë, duke respektuar trajtimin human dhe mirëqenien e kafshëve.
- Realizojnë anamnezën dhe kontrollin e sistemeve të ndryshme të organizmit.
- Administrimin e anestezisë dhe kryerjen e procedurave kirurgjikale dhe mjekësore me përpikmëri dhe siguri.
- Kryejnë inseminimin artificial dhe përcaktojnë shtatëzaninë tek kafshët.
- Realizojnë inspektimin ante-mortem dhe post-mortem të kafshëve.
- Diferencojnë inflamacionin akut nga ai kronik.
- Dallojnë midis lezioneve lokale dhe atyre të përgjithshme.

Kompetenca ndërdisiplinare dhe të zbatueshme në tregun e punës

Studentët do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë ndërlidhjen midis shëndetit të njeriut, kafshëve dhe mjedisit, në përputhje me qasjen “Një Shëndet” (One Health), duke bashkëpunuar me mjekë dhe profesionistë të shëndetit publik.
- Aplikojnë njohuritë veterinarë për adresimin e rreziqeve nga pandemitë globale me origjinë nga kafshët.
- Marrin pjesë aktive në iniciativat e kontrollit të zoonozave, epidemiologjisë dhe biosigurisë, duke garantuar shëndetin e tufës.
- Menaxhojnë financiarisht bizneset veterinarë duke balancuar kostot dhe fitimin.
- Marrin pjesë në grupe interesi ose komisione politike për hartimin dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fushën e veterinarisë.
- Ruajnë faunën e egër dhe mbrojnë biodiversitetin dhe ekosistemet përkatëse.

STRUKTURA E PROGRAMIT

Programi i Studimit në “Mjekësi Veterinare” realizohet gjatë pesë viteve, duke garantuar një shpërndarje të saktë dhe të balancuar të ngarkesës mësimore. Programi fokusohet në shëndetin e kafshëve, i cili ndërlihet ngushtësisht edhe me çështjet e shëndetit publik.

Gjatë dy viteve të para (paraklinike), studentët studiojnë lëndë themelore si: Anatomi, Histologji, Biologji, Kimikë, Fizikë, Fiziologji, Biokimi, Etologji, Botanikë, Biostatistikë, si dhe bazat e ushqyerjes dhe mbarëshimit të kafshëve. Modulet e formimit të përgjithshëm mundësojnë zhvillimin e kompetencave gjatë punës teorike dhe praktike, njohjen me metodologjinë statistikore dhe definicionet në informatikën mjekësore, duke mundësuar përpunimin dhe prezantimin e të dhënave. Këto module studiojnë funksionet jetësore themelore të organizmit si tërësi, si dhe të organeve dhe indeve në veçanti, duke mundësuar kështu arritjen e njohurive themelore për kuptimin e proceseve fiziologjike dhe biokimike. Njëkohësisht, ato japin parimet bazë të metabolizmit dhe ofrojnë një vështrim të strukturës dhe funksionit të molekulave, si dhe proceseve të rëndësishme metabolike që ndodhin brenda qelizave.

Gjatë tre viteve të tjera, studentët fokusohen në module që studiojnë agjentët patogjenë, të aftë të shkaktojnë patologji, si mikrobe, viruse dhe parazitë, përmes lëndëve si Mikrobiologji, Virologji, Imunologji dhe Parazitologji. Njëkohësisht, studentët studiojnë patologjitë specifike sipas specieve, të cilat kanë qëllim formues dhe bazohen në vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes klinike të kafshës gjatë kontrollit në lëndë si Propedeutikë, Sëmundjet e Derrave, Sëmundjet e Shpendëve, Sëmundjet e Njëthundrakëve dhe Sëmundjet e Kafshëve të Shoqërimit. Këto module synojnë vendosjen e një diagnoze të saktë klinike për përcaktimin e patologjive që mund të vërehen gjatë ekzaminimit klinik.

Në vitin e fundit, fokusi është te lëndët që lidhen me sigurinë ushqimore, duke vënë theksin në rolin parësor që ka mjeku veteriner në shëndetin publik. Në semestrin e fundit zhvillohet Praktika Profesionale, që përbën një komponent kyç të kurrikulës së programit të “Mjekësisë Veterinare”. Praktika synon t’u japë studentëve një përvojë praktike dhe bazë profesionale për përfundimin e studimeve, duke u realizuar në institucione dhe ambiente të ndryshme, si klinika veterinare private, ferma blegtorale, depo dhe farmaci veterinare, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Agjencia Kombëtare e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU).

Praktika ofron mundësinë e përdorimit të kompetencave të fituara përgjatë kurseve teorike në një kontekst praktik profesional, dhe ka për qëllim aftësimin e studentëve me konceptet bazë dhe aplikimet klinike në veprimtarinë praktike.

QASJA NDËRDISIPLINARE

Hartimi i këtij programi bazohet në ndërthurjen e kujdeshme të Lëndëve të Përgjithshme, Ndërdisciplinore/Integruese dhe Karakterizuese. Qasja ndërdisiplinore në Mjekësinë Veterinare fokusohet në ndërlihdjen e ngushtë midis shëndetit të njeriut, kafshëve dhe mjedisit. Ky program

gjithëpërfshirës siguron një formim adekuat përmes një qasjeje ndërdisiplinore, që synon zgjidhjen e problemeve komplekse të botës reale, si siguria ushqimore dhe parandalimi i zoonozave.

Për më tepër, për shkak të kompetencave ndërdisiplinore që fitohen, profesioni veterinar njihet si një pjesë kyçe e qasjes “Një Shëndet” — një koncept që përfshin bashkëpunimin ndërdisiplinor midis profesionistëve të sektorëve të ndryshëm, duke përfshirë mjekë, statistikanë, ekonomistë, ekspertë të mjedisit dhe publikun e gjerë.

Kjo qasje mbështet bashkëpunimin shumëpalësh midis profesionistëve të kujdesit shëndetësor, veterinerëve, ambientalistëve, shkencëtarëve dhe politikëbërësve, me qëllim adresimin e sfidave komplekse shëndetësore të kohës sonë.

PSE TË ZGJIDHNI KËTË PROGRAM?

Fakulteti i Mjekësisë Veterinare përfaqëson qendrën unike të edukimit të specializuar, duke ofruar bazën për ndërtimin e një karriere profesionale të suksesshme në këtë fushë. Programi i Studimit në “Mjekësi Veterinare” është përshtatur sipas Direktivës 2005/36/EC dhe në përputhje me kornizën e Procesit të Bolonjës, duke siguruar një kurrikul të integruar dhe bashkëkohor.

Ky program ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi të avancuara në fushën e shëndetit të kafshëve dhe sigurisë ushqimore, duke i përgatitur ata për sfidat moderne të profesionit.

Programi i Mjekësisë Veterinare ofron mundësi të shumta punësimi, duke lejuar të diplomuarit të ushtrojnë profesionin si specialistë të pavarur apo të hapin klinika veterinare me potencial për të siguruar të ardhura të qëndrueshme dhe të kënaqshme.

MUNDËSITË PAS DIPLOMIT

Diplomimi në Mjekësi Veterinare i hap studentëve një spektër të gjerë mundësish profesionale, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, brenda dhe jashtë vendit. Të diplomuarit kanë përgatitjen e duhur për të ndjekur karrierë në:

- Klinika veterinare për kafshë të vogla dhe të mëdha;
- Ferma bujqësore dhe qendra të mbarështimit të kafshëve;
- Institucione shtetërore të kontrollit veterinar dhe shëndetit publik;
- Agjenci të sigurisë ushqimore dhe inspektorate veterinare;
- Laboratorë diagnostikues dhe kërkimorë;
- Organizata ndërkombëtare si FAO, WHO, OIE etj.;
- Sektori farmaceutik;
- Karrierë akademike dhe kërkim shkencor në universitete dhe institute kërkimore.

Për më tepër, programi ofron bazat e nevojshme për ndjekjen e studimeve të mëtejshme pasuniversitare në fushat e specializuara të mjekësisë veterinarë, shkencave biomjekësore, epidemiologjisë dhe menaxhimit të shëndetit publik veterinar.

⇔ PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMET NDËRKOMBËTARE

Fakulteti i Mjekësisë Veterinarë zhvillon dhe forcon vazhdimisht partneritete strategjike me institucione akademike, qendra kërkimore dhe organizata profesionale në nivel ndërkombëtar. Këto bashkëpunime ofrojnë mundësi shkëmbimi akademik, projekte kërkimore të përbashkëta dhe zhvillim profesional për studentët dhe stafin akademik.

Përmes programeve si Erasmus+ dhe marrëveshjeve dypalëshe, studentët kanë mundësi të ndjekin studimet për një periudhë të caktuar në fakultete homologe në Bashkimin Europian dhe më gjerë, duke zgjeruar horizontet e tyre kulturore dhe profesionale.

Bashkëpunimi ndërkombëtar përmirëson cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke lejuar adoptimin e praktikave më të mira dhe teknologjive bashkëkohore në fushën e mjekësisë veterinarë. Kjo qasje ndihmon në përgatitjen e profesionistëve kompetentë që janë gati për sfidat globale në shëndetin e kafshëve, sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e mjedisit.

KURRIKULA E STUDIMEVE

Program i integruar i ciklit të dytë (MSc) në “Mjekësi Veterinarë”

Viti I, Semestri I (1)

Nr	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			në auditor	studim individual	Total	
1	Terminologji Mjekësore	3	29	46	75	D
2	Gjuhë e huaj	4	56	44	100	D
3	Kimi Inorganike	4	42	58	100	A
4	Hyrje në Anatomi	5	60	65	125	A
5	Bio. dhe Bio. Molekulare	5	56	69	125	A
6	Histologji-Embriologji	5	56	69	125	A
	Totali	26	299	351	650	

Viti I, Semestri II (2)

Nr	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			në auditor	studim individual	Total	
1	Histologji-Embriologji	5	56	69	125	A
2	Kimi organike	4	42	58	100	A
3	Anatomi topografike	6	60	90	150	A

4	Biofizikë	5	56	69	125	A
5	Sist bimë dhe kafshë	8	70	130	200	A
6	Inform. dhe Biostat.	6	56	94	150	D
	Totali	34	340	510	850	
	Totali viti I	60	639	861	1500	

Viti II, Semestri I (3)

Nr	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			në auditor	studim individual	Total	
1	Virologji Imunologji Vet.	6	57	93	150	B
2	Anatomi e Aplikuar	6	70	80	150	A
3	Gjenetikë	3	42	33	75	C
4	Etolo. Mirëqënie kafshë	4	42	58	100	C
5	Fiziologji Veterinare	4	42	58	100	B
6	Biokimi Veterinare	4	42	58	100	B
7	Mikrobiologji Veterinare	4	42	58	100	B
	Totali	31	337	438	775	

Viti II, Semestri II (4)

Nr	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			në auditor	studim individual	Total	
1	Fiziologji Veterinare	5	56	69	125	B
2	Biokimi Veterinare	5	56	69	125	B
3	Mikrobiologji Veterinare	4	42	58	100	B
4	Higjienë Veterinare	5	70	55	125	B
5	Të ushqyerit e kafshëve	6	70	55	125	C
6	Zootekni	4	42	83	125	C
	Totali	29	308	417	725	
	Totali viti II	60	645	855	1500	

Viti III, Semestri I (5)

Nr	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			në auditor	studim individual	Total	
1	Imazheri Veterinare	4	42	58	100	B
2	Met. shkenc. Shkrim Akad.	1	15	10	25	C
3	Diagnozë Laboratorike	5	56	69	125	C
4	Patologji e përgj.	6	75	75	150	B

5	Farmak. e Farm. Klinike	2	28	22	50	B
6	Propedeutikë Veterinare	5	56	69	125	C
7	Sëm. Infek. e Epidemio	2	28	22	50	B
8	Parazitologji veterinare I	4	42	58	100	B
	Totali	29	342	383	725	

Viti III, Semestri II (6)

Nr	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			në auditor	studim individual	Total	
1	Farmak. e Farm. Klinike	5	56	69	125	B
2	Propedeutikë Veterinare	5	56	69	125	C
3	Sëm. Infek. e Epidemio	7	70	105	175	B
4	Patologji e Veçantë	7	70	105	175	B
5	Parazitologji Veterinare II	6	56	94	150	B
6	Lëndë me zgjedhje	1	14	11	25	C
	Totali	31	322	453	775	
	Totali viti III	60	664	836	1500	

Viti IV, Semestri I (7)

Nr	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			në auditor	studim individual	Total	
1	Iktiopatologji	6	70	80	150	B
2	Riprodhim i kafshëve	4	56	44	100	B
3	Kirurgji Veterinare	6	70	80	150	B
4	Sëmundjet e Ripërtpësave	4	56	44	100	B
5	Sëm. kafshë shoqërimi	4	56	44	100	B
6	Sëm. njëthundrakë	4	56	44	100	B
	Totali	28	364	336	700	

Viti IV, Semestri II (8)

Nr	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			në auditor	studim individual	Total	
1	Riprodhim i kafshëve	5	56	69	125	B
2	Kirurgji Veterinare	6	70	80	150	B
3	Sëmundjet e Ripërtpësave	5	56	69	125	B
4	Sëm. kafshë shoqërimi	5	56	69	125	B
5	Sëm. njëthundrakë	4	42	58	100	B

6	Inspektim prod. shtazore I	6	70	80	150	B
7	Lëndë me zgjedhje	1	14	11	25	C
	Totali	32	364	436	800	
	Totali viti IV	60	728	772	1500	

Viti V, Semestri I (9)

Nr	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			në auditor	studim individual	Total	
1	Inspektim prod. shtazore II	6	70	80	150	B
2	Toksikologji Veterinare	5	56	69	125	B
3	Legjislacion Mjek. Ligjore	5	70	55	125	C
4	Sëmundje Derrash	5	58	67	125	B
5	Sëmundje Shpendësh	5	58	67	125	B
6	Sëmundje kafshë të egra	3	42	33	75	B
7	Lëndë me zgjedhje	1	14	11	25	C
	Totali	30	368	382	750	

Viti V, Semestri II (10)

Nr	Modulet	Kredite ECTS	Orë mësimore			Kategoria
			në auditor	studim individual	Total	
1	Praktikë Profesionale	15	0	375	375	D
2	Teza e Diplomës	15	0	375	375	E
	Totali	30	0	750	750	
	Totali viti V	60	368	1132	1500	
	Totali (I+II+III+IV+V)	300	3044	4456	7500	